

DISKUTIM INTELIGJENT NDËRAKTIV

**INTERPRETIMI I  
INFORMACIONEVE FINANCIARE  
DHE PËRDORIMI I TREGUESVE  
TË PERFORMANCËS  
NË SEKTORIN PUBLIK**

11 nëntor 2020

# CFRR»

**Centre for Financial  
Reporting Reform**



**WORLD BANK GROUP**

Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR)  
Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vjenë, Austri

Internet: [www.worldbank.org/cfrr](http://www.worldbank.org/cfrr)

Postë elektronike: [cfrr@worldbank.org](mailto:cfrr@worldbank.org)

Telefon: +43-1-217-0700

# PULSAR

Programi për Kontabilitetin dhe Raportimin në  
Sektorin Publik

Internet: [www.pulsarprogram.org](http://www.pulsarprogram.org)



**FOCAL**

Foro de Contadurías  
Gubernamentales de  
América Latina

Forumi i Kontabilistëve Shtetërorë i Amerikës Latine

Internet: [www.focal.red](http://www.focal.red)

## DISKUTIM INTELIGJENT NDËRAKTIV INTERPRETIMI I INFORMACIONEVE FINANCIARE DHE PËRDORIMI I TREGUESVE TË PERFORMANCËS NË SEKTORIN PUBLIK

11 nëntor 2020

### KONTEKSTI

Një prej objektivave kyç të kontabilitetit në përgjithësi është dhënia e informacioneve financiare në kohën e duhur, që janë të besueshme, aktuale, të krahasueshme, të kuptueshme dhe, më e rëndësishmja, të dobishme për vendimmarrjen.

Një mënyrë për t'ia rritur vlerën informacionit dhe raportimit financiar është me anë të zhvillimit të metodikës dhe përdorimit të treguesve financiarë dhe të performancës, si likuiditeti, leva financiare dhe raporti borxh/aktive neto, mes të tjera, që synojnë lehtësimin e analizës dhe interpretimit të pasqyrave financiare. Përdorimi i treguesve financiarë ndihmon edhe krahasimet ndërkombëtare dhe mund të mundësonte vlerësimin e ndikimit që ka COVID-19 në financat publike.

Objektivi kryesor i kësaj bisede ndëraktive inteligjente është: i) diskutimi i metodikës ekzistuese dhe i mënyrës si të përdoret më mirë në sektorin publik; ii) prezantimi i qëndrimit të BSNKSP-së për këtë temë; iii) eksplorimi i përfitimeve që sjellin pasqyrat financiare për investitorët dhe agjencitë e vlerësimit kreditor; iv) prezantimi i përvojës së vendeve/qyteteve në përdorimin e treguesve të performancës.

### VENDNDODHJET DHE ORA

- **07:00** – Qyteti i Guatemalës, Managua, Qyteti i Meksikos, San Hoze, San Salvador
- **08:00** – Bogota, Lima, Qyteti i Panamasë, Uashington D.K
- **09:00** – La Paz, Santo Domingo
- **10:00** – Asunsion, Brazilia, Buenos Aires, Montevideo, Santiago
- **14:00** – Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup, Tiranë, Vjenë, Zagreb
- **15:00** – Kishinav, Kiev
- **16:00** – Minsk
- **17:00** – Baku, Tbilis, Jerevan

## PROGRAMI | E MËRKURË 11 NËNTOR 2020, 14:00 (ORA E EVROPËS QENDRORE)

### Fjala e hapjes

14:00

**Dmitri Gourfinkel** | Drejtues i ekipit të projektit, KP-RF, PULSAR; Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore (Drejtues i punimeve të seminarit)  
**Daniel Boyce** | Menaxher Praktike për Qeverisjen në rajonin e EAQ-së, Banka Botërore  
**Xiomara Morel** | Menaxher Praktike për Qeverisjen në rajonin e ALK-së, Banka Botërore

14:15

### Qëndrimi i BSNKSP-së mbi përdorimin e treguesve financiarë dhe të performancës

**Ross Smith** | Drejtor programi dhe drejtor teknik, BSNKSP

14:30

### Përfitimet e pasqyrave financiare për investitorët dhe agjencitë e vlerësimit kreditor

**Fergus McCormick** | Drejtor i Studimeve Shtetërore, Aleanca e Investitorëve të Tregjeve të Reja

14:45

### Metodika ekzistuese dhe përvoja zvicerane

**Andreas Bergmann** | Drejtor, Sektori Publik, Fakulteti i Administrimit dhe të Drejtës ZHAW, Zvicër; ish-kryetar i BSNKSP-së

15:00

### Përvoja e qyteteve evropiane (grupeve CEFG/CSPF)

**Alexander Heichlinger** | Ekspert ndërkombëtar në qeverisjen lokale  
**Emanuele Padovani** | As. Profesor i menaxhimit dhe kontabilitetit publik, Universiteti i Bolonjës, Itali

15:15

### Fjala hapëse nga programi FOCAL dhe përvoja e Paraguit

**Magdalena del Pilar Vicuña Cevallos** | Zëvendësministre për Kontabilitetin Shtetëror, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ekuador, dhe Kryetare, FOCAL  
**María Teresa Díaz de Agüero** | Drejtoreshë e Përgjithshme për Kontabilitetin Publik, Ministria e Financave, Paraguai

## Pyetje & Përgjigje

---

15:30

**Jose Rezk** | Bashkëdrejtues i Ekipit të Projektit për KP-E, PULSAR; Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

**Juan Carlos Serrano** | Koordinator për programin FOCAL dhe Specialist i lartë për drejtimin financiar, Banka Botërore

## Fjala mbyllëse

---

15:40

**Arman Vatyan** | Drejtues i Programit PULSAR; Pikë Qendrore Kontakti për Qeverisjen për Azinë Qendrore, Banka Botërore

15:45

**Fundi i seminarit virtual**

---

## JETËSHKRIMET E FOLËSVE DHE DREJTUESVE TË SEANCAVE (sipas rendit të marrjes së fjalës)



### **DMITRI GOURFINKEL**

Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Drejtues Ekipi për KPRF PULSAR, Banka Botërore

Dmitri Gourfinkel është specialist i lartë për menaxhimin financiar pranë Praktikës Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore dhe ka 16 vjet përvojë profesionale në menaxhimin e financave publike dhe përputhshmërinë me detyrimet e besnikërisë në një sërë vendesh. Përpara se të fillojë punë në Bankën Botërore në vitin 2007, ka mbajtur disa poste në nivel të qeverisjes qendrore dhe nënqendrore në Meksikë, si Këshilltar i Ministrit të Financave, Kryekëshilltar i Zëvendësdrejtorit të Thesarit të Federatës dhe Kryekëshilltar i Kryetarit të Kontrollit të Shtetit për Qytetin e Meksikos. Dmitri është kontabilist publik i certifikuar nga Instituti Meksikan i Kontabilistëve të Autorizuar dhe ka kryer studimet e nivelit Master për administrim publik pranë fakultetit “Maxwell School of Citizenship dhe Public Affairs” të Universitetit të Sirakuzës. Dmitri është drejtues ekipi për Komunitetin e Praktikës për Raportimin Financiar programit PULSAR.



### **DANIEL BOYCE**

Menaxher i Praktikës së Qeverisjes, Banka Botërore

Daniel Boyce është Menaxher Praktike për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore në Praktikën Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore. Sektori që ai drejton mbulon 11 vende të Evropës Lindore, Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore. Është kontabilist publik i certifikuar (CPA), ka diplomë të studimeve universitare në kontabilitet nga Universiteti “A&M” i Floridës dhe mban titullin doktor në shkencë politike nga Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos (UCLA). Më parë ka drejtuar sektorin e menaxhimit financiar të Bankës Botërore për rajonin e Amerikës Latine dhe Karaibeve. Zoti Boyce është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së punës që bën Banka Botërore në fushën e qeverisjes, përfshirë punën në fushën e menaxhimit financiar operativ dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve në menaxhimin e sektorit publik. Temat të cilat trajtohen nga praktika e qeverisjes përfshijnë ndër të tjera temat e lidhura me reformën në drejtësi, ndërmarrjet shtetërore dhe menaxhimin e financave publike. Ai luan rol udhëheqës edhe në nisma rajonale të lidhura me menaxhimin e shpenzimeve publike dhe me kontabilitetin në sektorin publik.



### **XIOMARA MOREL**

Menaxhere e Praktikës së Qeverisjes, Banka Botërore

---

Zonja Morel është Menaxhere Praktike pranë Praktikës Globale për Qeverisjen në rajonin e Amerikës Latine dhe Karaibeve (ALK) të Grupit të Bankës Botërore. Është kontabiliste publike e certifikuar dhe ka diplomë të nivelit master në financë. Përvoja profesionale e zonjës Morel përfshin 25 vjet pranë Bankës Botërore, përfshirë menaxhim portofoli, rritje cilësie, kontabilitet publik dhe raportim financiar, menaxhim risku dhe zhvillim kapaciteti të institucioneve publike në vendet kliente të Bankës. Gjatë punës në Bankën Botërore, zonja Morel ka pasur arritje të shumta me ndikim të rëndësishëm operativ në vendet kliente në një shumëllojshmëri operacionesh të huadhënies dhe nismash të menaxhimit të financave publike, që i qasen qeverisjes që nga kontrolli i përmbushjes së detyrimit të besnikërisë, te ngritja e kapaciteteve e deri te reformat strategjike për menaxhimin e financave publike. Në postin e tanishëm, zonja Morel është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të politikës së menaxhimit financiar në operacionet e financuara nga Banka Botërore, menaxhimin me efektivitet dhe zhvillimin e mëtejshëm të portofolit ekzistues të operacioneve dhe punën analitike në rajonin e ALK-së, në mbështetje të strategjisë rajonale dhe programit të qeverisjes në vendet kliente.



### **ROSS SMITH**

Drejtor programi dhe drejtor teknik i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP)

---

Ross Smith është drejtor programi dhe drejtor teknik i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP). Ross udhëheq ekipin e BSNKSP-së në punën për hartimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP). Që prej fillimit të punës në BSNKSP në vitin 2013, Ross udhëheq përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të qeverisjes së BSNKSP-së dhe krijimin e Grupit Këshillimor Konsultativ të BSNKSP-së. Ross ka mbikëqyrur projektet e BSNKSP-së në lidhje me kontabilitetin e instrumenteve financiare (instrumentet financiare specifike të sektorit publik dhe SNKSP 41 “Instrumentet financiare”) dhe përgatitjen e strategjisë dhe planit të punës 2019-2023 të BSNKSP-së, përfshirë punën kërkimore dhe prezantimin e projektit të burimeve natyrore. Përpara punës në BSNKSP, Ross ka punuar disa vjet për njërin prej 4 firmave të mëdha të kontabilitetit në Kanada dhe në Japoni. Ross është fokusuar në detyra komplekse kontabiliteti dhe auditimi në lidhje me ndërmarrjet e shërbimeve publike, shoqëritë e mëdha industriale dhe institucionet financiare. Ross është kontabilist profesional i autorizuar në Kanada.



### **FERGUS MCCORMICK**

Drejtor i Studimeve Shtetërore, Aleanca e Investitorëve të Tregjeve të Reja

---

Fergus McCormick është Drejtor i Studimeve Shtetërore pranë Aleancës së Investitorëve të Tregjeve të Reja. Ai është edhe konsulent pranë Bankës Botërore dhe këshilltar i lartë pranë Qendrës “Kazarian” për Menaxhimin Financiar Publik. Përpara kësaj, Fergus ka qenë krye-ekonomist dhe shef i vlerësimeve ekonomike shtetërore pranë “DBRS Morningstar”, ekonomist për Amerikën Latine pranë “Morgan Stanley”, strateg për kapitalin global pranë “Bear Stearns”, analist shtetëror pranë “Fitch Ratings” dhe ekonomist/statisticien pranë Bankës Ndëramerikane për Zhvillim. Fergus ka diploma nga “Reed College” dhe Fakulteti i Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare “Paul H. Nitze” të Universitetit “Johns Hopkins”.



### **ANDREAS BERGMANN**

Drejtor, Sektori Publik, Fakulteti i Administrimit dhe të Drejtës ZHAW, Zvicër; ish-kryetar i BSNKSP-së

---

Andreas Bergmann është profesor i plotë i financave publike dhe drejtor për sektorin publik pranë Universitetit të Zyrihut për Shkencat e Aplikuara, Fakulteti i Administrimit dhe të Drejtës, prej vitit 2002. Më parë ka qenë Kryetar i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) nga viti 2010 deri në vitin 2015, dhe më parë ka qenë anëtar publik i bordit prej vitit 2006. Prej vitit 2009 është edhe anëtar i organit zviceran të vendosjes së standardeve kontabël për sektorin publik (SRS-CSPCP), dhe prej vitit 2010 anëtar i Grupit Këshillimor për Kontabilitetin të Komisionit Evropian. Në vitin 2010, zoti Bergmann ka qenë profesor i jashtëm pranë Universitetit “Victoria” në Uellington, Zelandë e Re. Ai është këshilltar shkencor për reformat e MFP-së në Zvicër, Evropë, Azinë Qendrore, Amerikën Latine, Azinë Juglindore, dhe në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Nga viti 2003 deri në vitin 2009, ka qenë këshilltar shkencor për reformat e kontabilitetit të sektorit publik në nivel federal dhe shtetëror në Zvicër. Ai ka qenë edhe anëtar, dhe më pas kryetar, i komitetit këshillimor për vënien në zbatim të GFSM2001/ESA95 në Zvicër. Në vitin 1999, ka filluar punë pranë Universitetit të Zyrihut për Shkencat e Aplikuara si Lektor i Lartë dhe u bë profesor i plotë në vitin 2002. Zoti Bergmann e ka filluar karrierën si konsulent biznesi përpara se të fillonte punë pranë Ministrisë së Arsimit të Shtetit të Zyrihut si Menaxher Projekti për Reformat NPM/Shef Kontrolli. Është diplomuar nga Universiteti i Lankasterit dhe mban diplomë master dhe doktoraturë nga Universiteti St. Gallen.





### **ALEXANDER HEICHLINGER**

Ekspert ndërkombëtar në qeverisjen lokale

---

Alexander Heichlinger deri në muajin shkurt 2020 ka qenë ekspert i lartë dhe menaxher në “EIPA Barcelona”, antenë e Institutit Evropian të Administratës Publike (EIPA). Është bashkëthemelues dhe kryetar i Grupit Ekonomik dhe Financiar të Qyteteve Evropiane ([www.cefg.eu](http://www.cefg.eu)) (2014-2020), ku bashkohen drejtorë dhe shefa finance të qyteteve kryesore evropiane për të nxitur menaxhimin e cilësisë, transparencën, llogaridhënien dhe qëndrueshmërinë e financave publike në nivel bashkie. Ai është edhe vëzhgues në Grupin e Punës midis Komisionit Evropian dhe Eurostatit për SEKSP-të. Gjatë më shumë se 20 viteve ka menaxhuar dhe realizuar detyra të shumta që cekin fusha dhe vende të ndryshme, si konsulent, si akademik and si instruktor për organizata të sektorit publik nga mbarë Evropa dhe më gjerë, si edhe për thujse të gjitha institucionet evropiane dhe organizata të tjera ndërkombëtare.



### **EMANUELE PADOVANI**

As. Profesor i Menaxhimit dhe Kontabilitetit Publik, Departamenti i Menaxhimit dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Bolonjës, Itali

---

Emanuele Padovani, Ph.D., është As. Profesor pranë Departamentit të Menaxhimit të Universitetit të Bolonjës, Itali. Ndër të tjera, është ekspert në kontabilitet dhe menaxhimin financiar, në sistemet e kontrollit të administrimit dhe në matjen dhe menaxhimin e performancës në qeverisjen rajonale dhe lokale. Ka bashkëpunuar në studime dhe projekte konsultimi me institucione të rëndësishme vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare në mbarë Italinë, Evropën dhe SHBA-në, përfshirë EIPA – Instituti Evropian për Administratën Publik (Vendet e Ulëta dhe Spanjë), KDZ - Zentrum für Verwaltungsforschung (Austri), Bertelsmann Stiftung dhe Shkolla Hertie School (Gjermani), SFIL (bankë publike për zhvillim, Francë) dhe Qendra MSU për Financat dhe Qeverisjen Vendore, Universiteti i Shtetit të Miçiganit (SHBA). Bashkëpunon me CNEL - Consiglio Nazionale dell'Economia e del Lavoro, organi kombëtar kushtetues që këshillon qeverinë dhe parlamentin mbi çështjet ekonomike dhe çështjet e lidhura me punën, për vlerësimin e performancës së njësive italiane të qeverisjes vendore. Prej shtatorit 2020, është drejtor shkencor i masterit ekzekutiv në financat publike vendore pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Bolonjës, për CDP - Cassa Depositi e Prestiti, banka kryesore italiane publike e investimeve.



### **MAGDALENA DEL PILAR VICUÑA CEVALLOS**

Zëvendësministre për Kontabilitetin Shtetëror, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ekuador

---

Zonja Vicuña është Zëvendësministre për Kontabilitetin Shtetëror në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave të Republikës së Ekuadorit. Punon si konsulente financiare me përvojë në projekte të Bankës Ndëramerikane për Zhvillim (IADB) dhe të Bankës Botërore. Është specialiste në përgatitje buxheti, kontabilitet dhe sisteme të thesarit dhe eksperte në projektimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të menaxhimit financiar. Zonja Vicuña ka marrë pjesë në hartimin e rregulloreve të financave publike në Ekuador dhe në zbatimin e sistemit të parë të integruar të menaxhimit financiar (SIGEF) në vend. Ka mbështetur Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave në zbatimin e Kodit Organik të Planifikimit dhe të Financave Publike dhe në shtjellimin e proceseve të ndryshme për realizimin financiar të burimeve publike. Zonja Vicuña ka drejtuar prezantime në seanca të UNCTAD - ISAR në Gjenevë dhe në Forumin e Kontabilitetit Shtetëror të Amerikës Latine - FOCAL. Është kryetare e forumit FOCAL për periudhën 2019-2020. Aktualisht punon për procesin e konvergencës me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) dhe për zbatimin e sistemit të ri të integruar administrativ të financave publike (SINAFIP) në Ekuador.



### **MARIA TERESA DIAZ DE AGÜERO**

Drejtoreshë e Përgjithshme e Kontabilitetit Publik, Ministria e Financave, Paraguai

---

María Teresa Díaz de Agüero është Drejtoreshë e Përgjithshme e Kontabilitetit Publik në Ministrinë e Financave të Paraguait me 30 vjet përvojë në këtë institucion. Ka diplomë të nivelit të parë në kontabilitet, diplomë master në formulim, vlerësim dhe menaxhim të projekteve të investimeve dhe diplomë pasuniversitare në didaktikë, të gjitha të fituara pranë Universitetit Kombëtar të Asunsionit, Paraguai. Gjatë 23 viteve të fundit, ka qenë profesoreshë në universitete të ndryshme. Zonja Díaz ka përvojë të gjerë në sektorin publik dhe sidomos në fushën e kontabilitetit të sektorit publik. Aktualisht, është menaxhere e Projektit Open Data SPIR, një aplikacion që synon t'i informojë qytetarët dhe vendimmarrësit e tjerë në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet në sektorin publik të Paraguait. Zonja Díaz udhëheq vënien në zbatim të SNKSP-ve në sektorin publik të Paraguait, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Në vitin 2016 ka qenë kryetare e Forumit për Kontabilitetin Shtetëror të Amerikës Latine (FOCAL), ku aktualisht është anëtare aktive. Është edhe anëtare nga sektori publik e Shoqatës Ndëramerikane të Kontabilitetit (AIC), ku përfaqëson Paraguain, dhe nënkryetare e Komisionit Teknik të Sektorit Publik pranë Kolegjit Paraguajan të Kontabilistëve për periudhën 2018-2020.




### **JOSE SIMON REZK**

Specialist I Lartë I Menaxhimit Financiar, Bashkëkryetar i Ekipit të Projektit për PULSAR EDUCOP, Banka Botërore

---

José Rezk ka diplomë të nivelit master në menaxhim strategjik dhe teknologji dhe diploma universitare në administrim biznesi dhe në kontabilitet. Mban edhe disa certifikata ndërkombëtare në kontabilitet dhe auditim, përfshirë titullin auditues i brendshëm i certifikuar (IIA), auditues sistemesh informatike i certifikuar (ISACA) dhe ekzaminues mashtrimi i certifikuar (ACFE). José ka mbi 20 vjet përvojë pune në menaxhim financiar dhe auditim, përfshirë edhe 15 vjet pranë Bankës Botërore. Në rolin e tij më të vonshëm si koordinator për menaxhimin financiar për Amerikën Qendrore, ka mbikëqyrur MFP-në dhe aspektet e detyrimit të besnikërisë të portofolave të projekteve për Kosta Rikën, El Salvadorin, Guatemalën, Hondurasin, Nikaraguan dhe Panamanë. Më parë, ka punuar si specialist i menaxhimit financiar për disa vende të Amerikës Latine, me qendër në Zyrat e Bankës Botërore në Argentinë dhe në Honduras. Ka udhëhequr disa studime të MFP-së, përfshirë PEFA kombëtare dhe nënkombëtare, dhe kohët e fundit ka udhëhequr organizimin e konferencave rajonale të dijes dhe mësimi, si CReCER dhe Cuentas Claras. Ka mbështetur dialogun me Rrjetin e Amerikës Latine të Kryefinancierëve Shtetërorë (FOCAL) me fokusin te fuqizimi i kontabilitetit në sektorin publik. Përpara Bankës Botërore, ka punuar në sektorin privat (sektori i teknologjisë së informacionit) si edhe në sektorin publik në Argentinë. Në CFRR Vjenë, José do të punojë për kontabilitetin në sektorin publik dhe raportimin financiar në sektorin privat.



### **JUAN CARLOS SERRANO**

Specialist i Lartë i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore

---

Juan Carlos Serrano është aktualisht koordinator për menaxhimin financiar për vendet e Andeve në Praktikën Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore dhe ndërlidhës me Forumin e Kontabilistëve Shtetërorë të Amerikës Latine (FOCAL). Përvoja e tij mbulon një gamë të gjerë fushash të reformës së MFP-së, me fokus te qeverisja, mbikëqyrja e detyrimit të besnikërisë, ofrimi i ngritjes së kapaciteteve qeverive dhe nismat strategjike të dialogut në nivel vendi. Gjatë punës në Bankën Botërore, zoti Serrano ka udhëhequr shumë nisma në mbarë rajonin e Amerikës Latine, ku janë përfshirë një gamë e gjerë institucionesh të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes, me synim përmirësimin e qeverisjes dhe zbatimin e reformave për transparencën dhe llogaridhënien. Përpara Bankës Botërore, zoti Serrano ka punuar gjerësisht në sektorët publikë dhe financiarë të Meksikës, pranë Njësisë Këshillimore të Ministrisë së Financave, Komisionit Meksikan për Bankat dhe Letrat me Vlerë dhe institucione të tjera bankare ndërkombëtare. Zoti Serrano është kontabilist publik i certifikuar

dhe ka diplomë të nivelit master në financa nga Instituti Meksikan i Teknologjisë Autonome (ITAM). Është anëtar aktiv i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit dhe është anëtar aktiv i organizatave të tilla si Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publikë të Certifikuar (AICPA) dhe Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA). Ka edhe Certifikatë në Raportimin Financiar Ndërkombëtare të lëshuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Autorizuar (ACCA) në Britaninë e Madhe.



### **ARMAN VATYAN**

Kryespecialist i Menaxhimit Financiar – Pikë Qendrore Kontakti për Praktikën Globale të Qeverisjes për Azinë Qendrore, Banka Botërore; Menaxher Programi PULSAR

---

Arman Vatyan, kontabilist i autorizuar në Britaninë e Madhe dhe Kanada, Drejtues Programi PULSAR është pikë qendrore kontakti për Praktikën Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore, i cili mbikëqyr zbatimin e veprimtarive të BB-së në fushën e Qeverisjes në Azinë Qendrore përfshirë në fushën e menaxhimit financiar. Ai ka më se 20 vjet përvojë në drejtimin e nismave dhe reformave të rëndësishme të menaxhimit financiar, përfshirë në kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik dhe atë privat, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm publik, sistemin e informacionit të menaxhimit financiar (FMIS) dhe kontrollin e brendshëm publik në 24 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ai drejton edhe Komunitetin e Praktikës për Auditimin e Brendshëm të PEMPAL në 23 vende (prej vitit 2008) dhe programe të tjera të suksesshme të MFP. Përpara se t'i bashkohej Bankës Botërore, ka punuar në KPMG për t'u ofruar këshilla për drejtimin e brendshëm, planifikimin strategjik, MIS, ristrukturimin, marrjet në pronësi dhe privatizimin qeverive dhe njësive ekonomike të mëdha me interes publik. Ka rreth 20 vjet përvojë në mësimdhënie në kurset e ACCA dhe si lektor i jashtëm në universitete dhe programe master.

## PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA


BASHKËFINANCOHET NGA



 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

**CFRR**   
**Centre for Financial  
Reporting Reform**



 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**